



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 11558 Prot

Shkodër, më 27.07.2021

Lënda: Në përgjigje të kërkeses suaj mbi mundësinë e vendosjes së Seatrac System për PAN.

Klinika e Ligjit pranë “Universitetit “Luigj Gurakuqi”

Bashkia Shkodër ka vlerësuar kërkesën tuaj, dërguar përmes emailit më datë 07.07.2021. Pas shqyrtimit të kërkesës ju informojmë se:

Bashkia Shkodër ka një eksperiencë në trajtimin dhe ofrimin e shërbimeve për personat me aftësi ndryshe. Bashkia Shkodër dallon ndër të gjithë bashkitë për përpjekjet e saj për ofrimin e shërbimeve, ndër të cilat listojmë disa nga më të rëndësishmet:

2. Qendra e Parë Ditore për Femijet me Aftësi Ndryshe në Shqipëri.
3. Shtëpia e Familje, e para në Shqipëri për fëmijët me aftësi ndryshe.
4. Prej disa vitesh kemi vendosur lodra për PAN në këndet e lodrave në lulishten në qendër të shatervani, tek pallatet parafabrikate në xhabije dhe oboorin e Qendrës së Zhvillimit.
5. Janë tetë shtëpitë Familje që ofrojnë shërbime të qendrueshme për Personat me Aftësi Ndryshe, në sajë të mbështetjes së Bashkisë Shkodër, shërbime që ofrohen në partneritet të ngushtë me organizata *Opera Modonnina del Grappa* dhe *Projekti Shpresa*.
6. Qendrat Komunitare “Për Familjen” në çdo lagje janë të aksesueshme për aktivitete dhe ofrojnë shërbime për personat me aftësi ndryshe sipas nevojës.
7. Kemi përshtatur dhe është funksional aksesimi për personat me aftësi ndryshe në institucionet e tjera publike, si biblioteka “Marin Barleti”, Qendra Rinore “Atelie”, Shkollat 9 vjecare, etj.
8. Qendra “Harmonia”, në shërbim të fëmijeve me çrregullime të spektrit të Autizimit është shërbimi më i ri në territorin e Bashkisë Shkodër. Kjo është qendra e parë publike në nivel vendor e ndërtuar dhe funksionale.
9. Bashkepunojmë nga afër me Organizata që shërbejnë PAN, shoqata e Paratetraplegjikeve dhe të tjera sipas aktiviteteve dhe projekteve të përbashkëta.

- i. shoqata e Para-tetraplegjikeve është mbeshtetur nga ana e Bashkisë Shkodër me ambiente për zyra dhe zhvillimin e aktiviteteve, pranë shkollës “Ali Lacej”.
- ii. kemi bashkepunuar ne zbatim të projektit për *Karten Blu* të parkimit për PAN dhe për pak ditë do të hapim aplikimin për paisjen me *Karten Blu* të parkimit për personat AN.
- iii. gjithashtu jemi në diskutime për shtimin e ambienteve për fizioterapi dhe terapi me anë të punës dhe besojme se do të gjejmë zgjidhjen e duhur për këtë shërbim.

Aksesueshmeria e personave me AN në hapësirën publike në det është një ekperiencë europiane që deri tani nuk kemi parë të zbatohet në Shqipëri, prandaj mirëpresim idenë dhe projektin e preventivin që ta adresojmë sa më parë në ndonjë Aplikim të mundshëm ose tek organizatat e shoqërisë civile.

KRYETAR
Voltana Ademi

The image shows a blue ink signature of Voltana Ademi over a circular official stamp. The stamp contains the text "REPUBLIKA E SHQIPERISE" at the top, "BASHKIA SHKODER" at the bottom, and a central emblem of an eagle. The signature is written in a cursive style and extends across the stamp.

